



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, 27. 11. 2018

VENDIM

Nr.35, datë 27.11.2018

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT "MASTER
PROFESIONAL NË UDHËRRËFIM DHE KOMUNIKIM TURISTIK"
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49 pika 1, neni 75 pika 1, VKM-së Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë" si dhe në Vendimin Nr. 76 datë 19.11.2018 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27. 11. 2018.

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ri të studimeve "Master Profesional në Udhërrëfim dhe Komunikim Turistik" në Fakultetin e Shkencave Humane.
2. Një kopje e këtij vendimi së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr.Rezana Vrapit- Kryetare

Florian Nurce- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT